



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë/Datum/Date:	10.05.2025
Për/Za/To:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga/Od/From:	Shkelzen Hajdini – Drejtor i DSHPS –së
Lënda/Subjecat/Subject:	Raport Mujor – Maj 2025

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur ju lutem gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën 01.05.2025 deri 31.05.2025.

RAPORT MUJOR PËR MUAJIN MAJ 2025

1. Përmbledhje ekzekutive

Më qëllim të ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore në QKMF, është vazhduar me zhvillimin e edukimit të vazhdueshëm profesional për personelin shëndetësor.

Meqë Komuna e Lipjanit, respektivisht QKMF në Lipjan është qendër demonstruese/qendër e exelencës, me përkrahje nga AQH-së, kemi pritur në vizitë Komunën/QKMF-në e Ferizajt dhe Komunën/QKMF-në e Hanit të Elezit. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë ndarja e përvojave të mira.

Të gjitha shërbimet në QKMF dhe punkte janë ofruar pa ndërprerje dhe janë mbuluar me personel të mjaftueshëm mjekësor.

Furnizimi nga Ministria e Shëndetësisë me barna esenciale ka qenë i pjesshëm dhe nuk ka arritur të mbulojë të gjitha nevojat.

Edhe muaji Maj është përcjellë me vështirësi për shkak të numrit të madh të pacientëve si pasojë e virozave sezonale duke shkaktuar ngarkesë të lartë, veçanërisht në laborator.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit kanë vazhduar edhe në këtë muaj.

2. Punët dhe aktivitetet e realizuara, bazuar në Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2024

Numri i ekzaminimeve mamografike të kryera në QKMF gjatë këtij muaji ka qenë i ulët. Gjithsej janë ekzaminuar 18 gra. Ky numër është shumë i ulët, marrë parasysh dobinë shëndetësore të këtij shërbimi dhe ndikimin e tij në shëndetin publik, Andaj, marrë parasysh këtë, ne jemi duke konsideruar mundësinë dhe alternativat për të rritur numrin e ekzaminimeve mamografike.

Në bazë të raporteve nga intervenimi i shërbimit të urgjencës të pranuar nga QKMF, në muajin Maj janë shënuar 36 aksidente trafiku. Krahasuar me muajin e kaluar, numri i rasteve të aksidenteve në trafik në këtë muaj ishte shumë më i lartë, 21 raste më shumë se në muajin paraprak.

Përfaqësues të QKMF-së kanë marrë pjesë në Konferencën e Mjekësisë Familjare të mbajtur më 14 dhe 15 maj 2025.

Shuma e të hyrave nga participimi në muajin maj ka qenë 8,328.50 €.

Përqindja e referimeve të jashtme për në shërbimin sekondar dhe terciar dhe sekondar gjatë këtij muaji ka qenë 8.46%. Kjo përqindje, siç është raportuar nga QKMF, vazhdon të mbetet në kuadër të përqindjes së lejuar për referimet nga KPSH.

3. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) gjatë muajit Maj janë kryer 41740 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Stafi mjekësorë	Niveli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithsej
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	11	9	20
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatrisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 84 Bachelor=29	17	96	113
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulet-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Shkollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Numri i punësuarve nga komuniteti jo shumice	Shkolla e mesme-3	1	2	3
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Fillore- 2 Shkolla e mesme-2	3	1	4

Gjithsej numri i punëtorëve	Shkollim superior =64, Shkollim bachelor =33, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesëm i ulët = 4	90	148	238
------------------------------------	--	----	-----	-----

Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në muajin Maj 2025:

Maj 2025-Vizitat Mjekësore

1	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në QKMF	8407
2	Vizita mjekësore nga mjeku Familjar /Përgjithshëm në Punte	4408
3	Vizita mjekësore Pediatrike	444
4	Vizita mjekësore Gjinekologjike	307
5	Vizita mjekësore Stomatologjike	652
6	Vizita mjekësore Pulmologjike	79
7	Vizita mjekësore Emergjente	4655
8	Vizita në kujdesin Paliative	214
9	Total	19166

Maj 2025- Shërbime Shëndetësore

1	Injeksione	7228
2	Infuzione	3741
3	Pastrim lidhje	1535
4	RTG	507
5	Laborator	2346
6	Lindje	0
7	Largim i penjve	105
8	Imobilizime	52
9	Oksigjenoterapi	112
10	EKG	549
11	Mamografi	18
12	USG	113
13	Vizita Shtëpiake me Autoambulancë	148

14	Transport me Autoambulancë	89
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendrën e azilit -Magure	0
17	Vizita në Qendrën e Paraburgimit	18
18	Rrahje	1
19	Këmbësor i lënduar me automjet	0
20	Konstatim vdekje	11
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	47
23	Aksidente trafiku	36
24	Dhunë familjare	1
25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	2348
27	Vaksina	1064
29	Shërbime stomatologjike	695
30	Referime	1622
31	Inhalime	34
32	Vizita infermierie gjinekologjike	26
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	63
34	Klasa për nëna	65
33	Gjithsej shërbime	22574

4. Qendra për Punë Sociale QPS

Të dhënat numerike për numrin e klientëve dhe shërbimeve në aspektin e klientëve dhe shërbimeve të asistencës në raste dhe për ndihmë sociale gjatë muajit, Maj/2025.

Tab. 1. Shërbimin Social: Shërbimet dhe klientët.

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i rasteve
<i>Fëmijët e keqtrajtuar- abuzuar (lënë pas dore)</i>	4	<i>Shërbime për të miturit në konflikt me Ligjin.</i>	14
<i>Të mitur në konflikt me ligjin.</i>	14	<i>Këshillim për bashkëshortët në martesë</i>	3
<i>Klient në nevojë për këshillime martesore.</i>	3	<i>Bashkimi familjar-kthimi në familje</i>	1
<i>Fëmijë me sjellje asociale- vështirësi në sjellje</i>	1	<i>Intervenim i Viktimave</i>	5
<i>Klient me aftësi të kufizuara- të rriturit</i>	2	<i>Besimi i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore</i>	3
<i>Klient me aftësi të kufizuara- Fëmijë</i>	1	<i>Shërbime për të rritur fëmijë me aftësi të kufizuar</i>	2
<i>Viktima të trafikimit</i>	1	<i>Shërbime për fëmijë me sjellje asociale</i>	1
<i>Viktimat e dhunës në familje</i>	5	<i>Këshilla Psiko-Sociale</i>	3
<i>Viktimat e krimeve seksuale</i>	/	<i>Intervenime gjatë orarit të Kujdestarisë</i>	3
<i>Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar (me status të huaj dhe mbrojtje ndërkombëtare)</i>	/	<i>Pjesëmarrje në PTHT/GJTHP</i>	5
<i>Kërkesë për kontaktim</i>	3	<i>Përfaqësues të përkohshëm</i>	1
<i>Klient tjerë në nevojë për shërbime</i>	56	<i>Intervenime te pergjithshme</i>	550
<i>Nr. i Përgjithshëm i Klientëve.</i>	91	<i>Nr. i Përgjithshëm i Shërbimeve</i>	592

Tabela 2. Shërbimet e asistencës sociale.

	Aktivitetet		Kategoria 1	Kategoria 2	Gjithsej
APLIKIMI	1.Numri i rasteve që kanë aplikuar për herë të parë.		7	6	11
	<i>Sa prej tyre janë të aprovuara.</i>		3	5	8
	<i>Sa janë në shqyrtim .</i>		1	2	3
	<i>Sa prej tyre janë të refuzuara .</i>		0	0	0
RIAPLIKIMI	2. Numri i rasteve të larguara për mos ri-aplikim.		4	3	7

	2.1 Numri i rasteve që kanë ri-aplikuar.		40	47	87
	2.2 Numri i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacioni.		3	4	7
VERIFIKIMI	3.Numri total i familjeve të verifikuara/ri-verifikuara.		38	47	85
	Sa prej tyre janë aprovuar		32	41	73
	Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar		6	6	12
KOMISIONI MJEKWSOR	4. Numri i rasteve të dërguara. në Komision Mjekësor (KM) .		60	0	60
	Numri i rasteve të aprovuara nga KM.		60	0	60
	Numri i rasteve të refuzuara nga KM.		0	0	0
	Numri i rasteve të kthyer nga KM për kompletim dokumentacioni.		0	0	0
	3.Numri i ankesave të paraqitura nga Shfrytëzuesit .		0	0	0
	A. Në shkallë të parë(I).		0	0	0
	B. Në shkallë të dytë(II)		0	0	0
	Numri i ankesave të aprovuara.		0	0	0
	Numri i ankesave të refuzuara.		0	0	0
	Numri i ankesave në shqyrtim.		0	0	0
	Kontestet në Gjykata.		0	0	0
	a)Kontestet të pranuar.		0	0	0
	b)Konteste të refuzuara.		0	0	0

5. Shtëpia me Bazë në Komunitet

Gjendja shëndetësore e rezidentëve gjatë këtij muaji në përgjithësi ka qenë e mirë.

6. Investimet Kapitale

Projekti Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit është duke vazhduar.

7. Vështirësitë dhe sfidat

- Gjatë muajit maj ka pasur një fluks relativisht të lartë të pacientëve, kryesisht për shkak të virozave sezonale dhe gripit. Rritja më e madhe e pacientëve është vërejtur në laboratorin e QKMF-së.
- Furnizimi i pjesshëm me barna dhe materiale mjekësore nga Ministria e Shëndetësisë.
- Reduktim i hapësirave të punës si pasojë e punimeve për ndërtimin e objektit të ri.
- Mungesë e stafit teknik dhe mbështetës në QKMF, si dhe prezenca e stafit të moshuar në këtë sektor.
-

8. Planifikimi për muajin Qershor 2025

- Në muajin e ardhëm, më 11 Qershor 2025, në QKMF Lipjan pritet të organizohet Mbledhja e Komitetit Drejtues Projekti i Kujdesit Shëndetësor të Qasshëm dhe Cilësor (AQH), Faza III (2024-2027).
- Do të mobilizohemi dhe do të bëjmë përgatitjet për të përballuar sfidat sezonale të cilat priten gjatë muajve të pushimit Korrik dhe Gusht. Gjatë këtyre muajve pritet të rritet numri i pacientëve për shkak të ardhjes së mërgimtarëve dhe mbretërimit të temperaturave të larta.
- Parashihet zbatimi i aktiviteteve sipas planit të veprimit për vitin 2025, me fokus në ofrimin dhe forcimin e shërbimeve të integruara shëndetësore.
- Do të vazhdohet me edukimin profesional të vazhdueshëm të stafit mjekësor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.